



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
DREJTORIA E PROVIMEVE TË SHTETIT

N J O F T I M

***PËR ZHVILLIMIN E TESTIMIT TË INFORMATIZUAR TË KANDIDATËVE PËR T’U
PUNËSUAR NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
PORTALI I MËSUESIT 2025***

Në zbatim të Udhëzimit nr. 9, datë 03.05.2024 “Për organizimin e testimit të informatizuar të kandidatëve për t’u punësuar në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar”, si dhe shkresës së MAS nr. 3176 prot., datë 21.05.2025 “Për realizimin e procedurave të konkurrimit të mësuesve në portalin “Mësues për Shqipërinë”, ju informojmë se testimi i informatizuar do të zhvillohet në mesin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore, me adresë Bulevardi “Zhan D’Ark”, Nr. 23, Tiranë (ish-ATSH), gjatë periudhës **Korrik – Gusht 2025**.

Ditën e zhvillimit të testimit të informatizuar, kandidatët duhet të kenë parasysh rregullat e mëposhtme:

- a) Të jenë të pajisur me dokument identiteti (kartë identiteti ose pasaportë);
- b) të paraqiten së paku 30 minuta përpara fillimit të testimit;
- c) të mos mbajnë dhe të mos përdorin celularë dhe mjete të tjera të komunikimit gjatë zhvillimit të testimit, pasi kjo vlerësohet si kriter përjashtimi;
- ç) të mos pinë duhan dhe të mos konsumojnë ushqime në mjediset e testimit;
- d) të mos komunikojnë me njëri-tjetrin gjatë zhvillimit të testimit.

Kalendari i organizimit të testimit dhe orari i pjesëmarrjes në testim për çdo kandidat, do të publikohen në vijim në faqen zyrtare të Qendrës së Shërbimeve Arsimore www.qsha.gov.al. Orari i pjesëmarrjes në testim do të jetë i përcaktuar dhe nuk do të mund të ketë ndryshime.

Ju urojmë Suksese!